



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Zyra e Sekretares së Përgjithshme - Kancelarija Generalnog Sekretara - Office of the General Secretary

Nr. 53 /2024
Datë 10/05/2024

Në mbështetje të nenit 18 të Ligji Nr. 06/L-113 Për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës /Nr. 7/01 Mars 2019), duke u bazuar në nenin 11 (paragrafi 3) të Rregullores QRK-Nr. 01/2020 për standardet e organizimit të brendshëm, sistematizimin e vendeve të punës dhe bashkëpunimin në institucionet e administratës shtetërore dhe agjencitë e pavarura, Sekretarja e Përgjithshme të Ministrisë së Drejtësisë, nxjerr:

V E N D I M

1. Emërohet grupi punues për hartimin e Projektligjit për plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit Nr. 06/L-009 për Ndërmjetësim, në këtë përbërje:
 - 1.1. Valmira Maxhuni Uka, DL/MD, Kryesuese;
 - 1.2. Eros Gashi, Kabineti i Ministres/MD, Zv. Kryesues;
 - 1.3. Labinot Gashi, DPL/MD, Anëtar;
 - 1.4. Përfaqësues nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Anëtar;
 - 1.5. Përfaqësues nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, Anëtar;
 - 1.6. Përfaqësues nga Akademia e Drejtësisë, Anëtar;
 - 1.7. Përfaqësues nga Oda e Ndërmjetësuesve të Kosovës, Anëtar;
 - 1.8. Përfaqësues nga Ambasada Amerikane, FMCS;
 - 1.9. Përfaqësues nga USAID, Programi për Drejtësi Komerciale;
2. Sipas nevojës dhe me qëllim të realizimit të obligimeve të përcaktuara me këtë vendim, Kryesuesi i Grupit Punues mund të ftojë edhe përfaqësues nga institucionet e tjera vendore dhe ndërkombëtare si dhe organizatat e shoqërisë civile.
3. Grupi punues nga pika një (1) e këtij vendimi obligohet t'i përmbahet rregullave dhe procedurave të përcaktuara me Rregulloren e Punës së Qeverisë Nr. 09/2011 si dhe standardeve në fuqi për hartimin e legjislacionit.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi i dërgohet:

- *Anëtarëve të Grupit Punues;*
- *Kabinetit të Ministres/MD;*
- *Zyrës së Sekretares së Përgjithshme/MD*
- *Arkivit të MD-së.*